Shkaqet e Martesave të Hershme tek

Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian

në Komunën e Fushë Kosovës

Financuar nga**:** Mbështetur nga: Implementuar nga:

Prishtinë, 2020

Detajet botuese dhe mirënjohjet

Autore dhe analiste e hulumtimit
Anita Plakolli

Analiste të statistikave
Blertë Fazliu
Donjeta Jashari

Koordinatore të Hulumtimit:
Arijeta Islami
Donjeta Jashari

Fotografe:
Leona Tahiri

Këshilltare e Hulumtimit
Elizabeth Gowing

Zyrtare e Financave
Tea Dujaka

Ekipi Hulumtues:
Donjeta Jashari
Blertë Fazliu
Jeton Jashari
Mirlinda Gërguri
Bajramshah Shala

Lektore:
Bleta Qormemeti Berisha

Dizajni grafik:
Susan Jones

Pjesëmarrësit e Fokus Grupit të Profesionistëve;
Lumnije Behrami
Saranda Uka
Bledor Kalleci
Arrita Gola
Samir Shahini
Arbon Osmani
Mirlinda Gërguri
Altina Nika
Gëzime Gegaj

Botues:
The Ideas Partnership

Hulumtimi është mbështetur zemërgjërsisht nga Dannish Refugee Council dhe financuar nga Swedish International Development Cooperation Agency (Sida) në kuadër të projektit “Free to Choose; Free to Learn”, implementuar nga Organizata “The Ideas Partnership”.

Përmbajtja:

1. Përmbledhje ekzekutive 7
2. Hyrje 8
3. Qëllimi i hulumtimit 9
4. Metodologjia 9
5. Qëllimet e anketimit / grumbullimit të të dhënave 10
6. Gjetjet kryesore të anketimit dhe të dhënat demografike 10
7. Qëllimet e intervistave të thella, Fokus Grupeve dhe Studimit të Rastit 18
8. Gjetjet kryesore të intervistave të thella 19
9. Fokus Grupet 22

9.1 Përmbledhje e Fokus Grupit me vajzat 22

9.2 Përmbledhje e Fokus Grupit me djemtë 23

9.3 Përmbledhje e Fokus Grupit me gratë 25

9.4 Përmbledhje e Fokus Grupit me profesionistë të fushave të ndryshme 27

9.5 Gjetjet kryesore të Fokus Grupeve 31

10. Studimi i Rastit 32

10.1 Gjetjet kryesore të Studimit të Rastit 38

11. Konkluzionet 39
12. Rekomandimet 39

1. Përmbledhje ekzekutive

Ky hulumtim synon të kuptojë shkaqet e martesës së hershme tek komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në lagjet 28 dhe 29 në Fushë Kosovë.

Pyetësorët u realizuan me 300 anëtarë të komuniteteve të synuara nga një ekip vullnetar i cili, në përputhje me politikën e organizatës "The Ideas Partnership" për hulumtime, kanë përfshirë pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. 20 intervista më të thella, katër Fokus Grupe dhe një studim i rastit shtjellojnë disa nga pyetjet dhe çështjet e ngritura në hulumtim.

Gjetjet kryesore:

- Shumica e të anketuarve (62% e burrave dhe 54% e grave) thanë që prindërit e tyre nuk kishin ndikuar në vendimin e tyre për t'u martuar.
- 12% e të anketuarve përmendën një shtatzëni të paplanifikuar si arsye të martesës së hershme, por kjo shifër ishte dy herë më e lartë për burrat sesa për gratë.
- Martesat e shumicës (87%) e të anketuarve nuk ishin regjistruar në komunë.
- 32% e të anketuarve nuk e dinin se ekziston një ligj që ndalon martesën nën moshën 18 vjeç.
- Të intervistuarit përmendën presionin shoqëror si shkak për t'u martuar më të rinj dhe se nëse do të supozohej se ishin të sëmurë ose kishin bërë diçka të keqe, atëherë askush nuk do të martohej me ta.

Çështjet që ndikojnë te shfaqja e martesave të hershme të identifikuara në Fokus Grupet janë:

- pabarazia gjinore
- braktisja e shkollës
- varfëria
- mungesa e informacionit
- traditat kulturore
- prindërit e shohin martesën si një mënyrë për të rehatuar fëmijët e tyre
- jetëgjatësia e shkurtër për këto komunitete
- politikat e mirëqenies sociale që ofrojnë stimulime financiare për familjet me fëmijë nën moshën 5 vjeç
- Komunikimi jo i mirëfilltë midis prindërve dhe fëmijëve të tyre adoleshentë

Raporti përfundon me rekomandime për institucionet, shoqërinë civile dhe komunitetet ku martesa e hershme është e përhapur.

2. Hyrje

Martesat e fëmijëve, sipas ligjit, konsiderohen si bashkim në mënyrë tradicionale i dy personave të mitur, nën moshën tetëmbëdhjetë vjeçare, pa autorizimin përkatës të institucioneve përgjegjëse, janë shkelje e të drejtave të njeriut.

Kjo dukuri prek të dyja gjinitë, mirëpo në bazë të statistikave, në të shumtën e rasteve, vajzat janë viktima të këtij fenomeni. Sipas hulumtimit të organizatës "The Ideas Partnership" mbi martesat e hershme, i publikuar në vitin 2017[1], shkaqet e këtyre martesave te komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Fushë Kosovës lidhen ngushtë me mungesën e edukimit dhe braktisjen e shkollës. Për ta hulumtuar tutje këtë fenomen dhe për t'i kuptuar shkaqet e tjera të cilat ndikojnë në paraqitjen e martesave të hershme, gjatë vitit 2018 dhe 2019 kemi realizuar edhe këtë hulumtim.

Ky hulumtim është realizuar në kuadër të projektit "Free to choose; Free to learn", mbështetur nga Danish Refugee Council. Projekti ka për qëllim adresimin e një prej sfidave kryesore të kohezionit social me të cilin përballet komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian i Fushë Kosovës - manifestimi i pabarazisë gjinore në martesat e hershme, që i heq vajzat nga arsimi dhe i mban larg rrjeteve të tyre mbështetëse. Rritja e numrit të viteve të kaluara në shkollë ka përfitime në fushën e punësimit, të stabilitetit ekonomik dhe të shëndetit. Hulumtimi ynë tregon se martesa shënon fundin e edukimit, kështu që fenomeni i martesës së hershme dhe edukimi janë shumë të lidhura.

Organizata "The Ideas Partnership" synon ta trajtojë çështjen e martesave të hershme përmes:

- Rritjes së ndërgjegjësimit të nënave rom, ashkalie dhe egjiptian për të drejtat e vajzave të tyre
- Vetëdijësimit të vajzave për të drejtat e tyre
- Mbështetjes së vajzave me burime praktike për të qëndruar në shkollë
- Krijimit të një kuadri të punonjësve të ardhshëm socialë që vijnë nga komunitetet e synuara të cilët i japin përparësi dhe trajtojnë çështjen e martesave të hershme
- Hulumtimit të faktorëve që ndikojnë në martesat e hershme
- Fuqizimit të grave dhe vajzave nga komunitetet e synuara për të shprehur aspiratat e tyre për arsimim të vazhdueshëm kundër martesës së hershme dhe për t'i ndarë këto aspirata me mbështetësit e mundshëm

[1] http://theideaspartnership.org/wp/?page_id=701

3. Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi i këtij hulumtimi është grumbullimi i të dhënave në mënyrë që të sigurohet informacion sasior dhe cilësor mbi shkaqet e martesave të hershme te komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Fushë Kosovës, përkatësisht në lagjet 28 dhe 29.

Përmes këtij hulumtimi, organizata "The Ideas Partnership" me mbështetjen e Danish Refugee Council dhe në kuadër të projektit "Free to Choose; Free to Learn" është munduar t'i identifikojë shkaqet e këtij fenomeni dhe faktorët e tjerë socio-ekonomik të cilët mund të ndërlidhen me këtë dukuri. Të gjeturat të cilat përfshihen në këtë raport janë material i rëndësishëm dhe mund të shërbejnë për institucionet kompetente të nivelit lokal dhe qendror për hartimin e strategjive përkatëse që ndihmojnë në parandalimin e kësaj dukurie.

4. Metodologjia

Hulumtimi është realizuar duke përdorur metodat kuantitative dhe kualitative. Ky studim mbulon lagjet 28 dhe 29 të komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Fushë Kosovës.
Në pjesën kuantitative të hulumtimit janë përfshirë gjithsej 300 respondentë, respektivisht 152 femra dhe 148 meshkuj, të cilët janë përzgjedhur me metodën e rastit. Të dhënat demografike të respondentëve përfshijnë: moshën, gjininë, nivelin arsimor dhe etninë. Hulumtimi është realizuar përmes pyetësorit i cili ka përfshirë pyetje përmes të cilave është arritur të kuptohen disa nga shkaqet e martesave të hershme te komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Fushë Kosovës.

Të gjithë pyetësorët janë koduar dhe përpunuar me softuerin SPSS 19. Të gjitha përgjigjet janë analizuar duke pasur parasysh krahasimet me ndryshore si: gjinia, mosha, niveli i arsimimit, statusi social dhe profesioni. Margjina e gabimit është +/- 3%.

Në pjesën kualitative të këtij hulumtimi janë realizuar gjithsej:

- 20 intervista të thella me respondentë të cilët vijnë nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian
- 4 Fokus Grupe
- një studim i rastit

Identiteti i respondentëve në këtë studim mbetet i mbrojtur në përputhshmëri me kodin e etikës, përkatësisht ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale[2] dhe të dhënat e mbledhura në terren do të përdoren vetëm për qëllime shkencore.

[2] https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18616

5. Qëllimet e anketimit / grumbullimit të të dhënave janë vleresimet e:

- nivelit të shkollimit të respondentëve
- të hyrave mujore dhe numri i të punësuarve në familje
- statusit martesor dhe sipas rastit mosha në të cilën janë martuar
- ndikimit të prindërve në vendimin për martesë
- arsyes së marrjes së vendimit për t'u martuar dhe mënyra e lidhjes së martesës
- perceptimit të respondentëve për moshën e duhur për martesë
- njohurive të respondentëve për moshën e lejuar për martesë sipas ligjit

6. Gjetjet kryesore të anketimit dhe të dhënat demografike

Në pjesën kuantitative të hulumtimit kanë marrë pjesë përafërsisht një numër i barabartë i respondentëve të të dyja gjinive, janë intervistuar gjithsej 300 respondentë, prej të cilëve 152 femra dhe 148 meshkuj.

Shkalla e arsimimit



Figura 1: Shkalla e arsimimit

Grafikoni i mësipërm paraqet nivelin arsimor të respondenteve të intervistuar. Respondentët të cilët nuk kanë qenë asnjëherë pjesë e sistemit arsimor janë gjithsej 48.3%. Një pjesë e konsiderueshme e tyre nuk e kanë të përfunduar nivelin fillor të arsimimit, ku hyjnë 29.3% e të anketuarve. Me nivelin fillor të përfunduar kemi 13.7% të të intervistuarve. Me shkollë të mesme të përfunduar janë 8% të anketuar, kurse vetëm 0.7% e të anketuarve kanë vijuar shkollimin universitar.

Hulumtimi "Schools Out" i Balkan Sunflowers Kosova, realizuar më 2012, nxjerr një pasqyrë të ngjashme të gjendjes së nivelit arsimor sa i përket përqindjes së popullatës në Fushë Kosovë të cilët nuk kanë shkuar kurrë në shkollë. Kështu, prej 1038 personave të intervistuar në Fushë Kosovë që vijnë nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, 52.5% kanë qenë të pashkolluar, 2.8 % kanë të përfunduar nivelin fillor, 0.4 % kanë vijuar shkollën e mesme dhe vetëm 0.3% kanë vijuar fakultetin[3].

Nëse i krahasojmë këto të dhëna të vitit 2012 me vitin 2018, kur edhe është realizuar anketimi ynë, do të shohim se përveç përqindjes së respondentëve që nuk kanë shkuar kurrë në shkollë e që është e përafërt, gjendja e përfundimit të shkollimit të nivelit fillor, të mesëm dhe atij të lartë duket që ka përmirësim. Megjithatë, përqindja e lartë e personave të pashkolluar fare, vazhdon të mbetet mjaft brengosëse.

Të hyrat mujore familjare



Figura 2. Të hyrat mujore familjare

[3] http://the-strategy.org/Schools%20Out_English.pdf

Tab 1.: Të hyrat mujore familjare të të anketuarve:

Numri i familjeve	Të hyrat mujore
180	0 deri 199 Eur
35	200 deri 299 Eur
3	600 deri 699 Eur
6	1000 deri 1400 Eur
12	Nuk kanë të ardhura
64	Nuk janë deklaruar

Lidhur me të hyrat mujore të të anketuarve në tabelën dhe figurën më lart, mund të shohim se 60% të familjeve kanë të hyra mujore deri në 199 euro, 10.5% të familjeve jetojnë me 200 deri 299 euro në muaj, 1% e familjeve të anketuara kanë të hyra mujore 600 deri 699 euro, 2% kanë deklaruar 1000 deri 1400 euro, ndërsa me asnjë burim financiar janë deklaruar 4% të respondentëve. Pjesa tjetër e respondentëve nuk kanë dashur të deklarohen në lidhje me të hyrat mujore.

Sa anëtarë të familjes suaj punojnë?



Figura 3: Sa anëtarë të familjes suaj punojnë?

Në pyetjen e parashtruar ndaj respondentëve se sa anëtarë të familjes së tyre janë në marrëdhënie pune, një pjesë e konsiderueshme e tyre kanë pohuar se asnjë anëtar i familjes së tyre nuk ka një punë të sigurtë. Gjegjësisht, 56% prej tyre kanë deklaruar se nuk kanë asnjë të punësuar. Nga total 300 respondentë, 97 e të anketuarve kanë deklaruar se punon vetëm kryefamiljari, kryesisht si mbledhës kanaçesh dhe 19 respondentë pohojnë se vetëm 2 persona në familje punojnë, ndërsa për më shumë anëtarë të punësuar në familje kemi një përqindje të ulët siç edhe shihet në figurën 3.

A jeni i/e martuar? Nëse po, në çfarë moshe jeni martuar?



Figura 4. A jeni i/e martuar dhe nëse po, në çfarë moshe?

Nga figura 4, mund të shohim se mosha që dominon më së shumti kur janë lidhur martesat është 18 vjeç, ose 15.67% të respondentëve. 7% të respondentëve janë martuar në moshën 17 vjeçare dhe 5.33% në moshën 16 vjeçare. Në moshën 15 vjeç janë martuar 12% të respondentëve. Të njëjtën përqindje 2% e hasim te martesat në moshën 13 dhe 14 vjeç. 17 respondentë ose 5.67% nuk kanë qenë të martuar.

Tab 2.: Mosha e martesës sipas gjinisë, deri në 18 vjeç

	Gjinia	
Mosha	**Femra**	**Meshkuj**
13 vjeç	4	2
14 vjeç	3	3
15 vjeç	19	17
16 vjeç	10	6
17 vjeç	12	9
18 vjeç s	30	17

Ligji për familjen, neni 16, thekson se: "(1) Personi i cili nuk ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeçare nuk mund të lidhë martesë"[4], poashtu ky nen përcakton se në bazë të disa kushteve mund të lejohet martesa nën tetëmbëdhjetë vjeç "(2) Për shkaqe të arsyeshme dhe sipas kërkesës së tij, gjykata kompetente mund t'i lejojë martesën personit të mitur më të vjetër se gjashtëmbëdhjetë

[4] https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2410

vjet, nëse konstaton se personi i tillë ka arritur pjekurinë e nevojshme fizike dhe psikike për të ushtruar të drejtat e veta martesore dhe për të përmbushur detyrimet martesore.[5]

Hulumtimi mbi martesat e hershme në Fushë Kosovë, realizuar nga organizata "The Ideas Partnership" në vitin 2017[6] tregon të dhëna të ngjashme për moshën e lidhjes së martesës ku nga 502 respondentë, në moshën trembëdhjetë vjeçare kanë lidhur martesë 1.39% të respondentëve, në moshën katërmbëdhjetë vjeçare 6.57% të respondentëve, më moshat pesëmbëdhjetë dhe gjashtëmbëdhjetë vjeç 28.28%, në moshën shtatëmbëdhjetë vjeç 17.3%, ndërsa 44.42% të respondentëve janë martuar nga mosha tetëmbëdhjetë deri njëzet e katër vjeç.

Nëse i krahasojmë këto të dhëna nga të dy hulumtimet del se kemi një dallim të vogël në mes të lidhjes së martesave nën moshën 18 vjeç. Përmirësim i lehtë vërehet te martesat në moshën 13, 14 vjeç dhe në moshën 14 dhe 15 vjeç, ndërsa një dallim dhe përmirësim i konsiderueshëm që ka ndodhur brenda dy viteve vërehet te lidhja e martesave në moshat 16 dhe 17 vjeç.

A kanë ndikuar prindërit tuaj në vendimin për martesë?



Figura 5: A kanë ndikuar prindërit tuaj në vendimin për martesë?

Lidhur me ndikimin e prindërve në vendimin për martesë, 44.7% të femrave janë deklaruar se prindërit kanë ndikuar në vendimin për martesë, ndërsa 53.9% të femrave janë përgjigjur me jo. Në anën tjetër, 34% të meshkujve të anketuar janë deklaruar se prindërit kanë ndikuar në vendimin për martesë, ndërsa 61.8% janë deklaruar me jo. Këtu mund të vërehet se prindërit më shpesh ndikojnë në vendimmarrje për vajzat sesa për djemtë. Nga numri total i respondentëve të të dy gjinive, 57% e tyre kanë deklaruar se prindërit e tyre nuk kanë ndikuar në vendimin e tyre për martesë, ndërsa 39% e respondentëve kanë pohuar se prindërit e tyre kanë pasur ndikim në këtë

[5] https://www.avokatia.eu/sh/docs/ligjet/LIGJI%20MBI%20FAMILJEN%20I%20KOSOVES.pdf
[6] http://theideaspartnership.org/wp/?page_id=701

vendim. Kurse pjesa e mbetur prej 2.7% kanë pohuar se deri diku prindërit kanë ndikuar në vendimin e tyre për martesë.

Tab 3.: Pse keni vendosur të martoheni?

	Numri i respondentëve	
	Meshkuj	**Femra**
Shtatzënia e paplanifikuar	24	11
Mentaliteti në komunitet	58	81
I Kam konsideruar se është koha e duhur për martesë	37	44
Dëshira për të krijuar familje	12	8
Ndërprerja e shkollimit	2	9
Kushtet e vështira ekonomike	8	5

Në njërën nga pyetjet kryesore të anketimit, pjesa më e madhe e respondentëve kanë theksuar se vendimi për martesa të hershme ndikohet nga mentaliteti i komunitetit ku jetojnë. Nga numri total i respondenteve, 46.3% kanë pohuar se martesa është normë kulturore dhe pritshmëri nga rrethi ku jetojnë dhe ky mendim dominon dukshëm te femrat. Një numër i konsiderueshëm kanë deklaruar se ka qenë zgjedhja e tyre personale që të martohen, përkatësisht 27% e respondenteve kanë pohuar se kanë vendosur të martohen me vullnetin e tyre. Një arsye tjetër që respondentët kanë theksuar, është fenomeni i shtatzënisë së paplanifikuar që pastaj ndikon në vendimin për martesë, posaçërisht te meshkujt. Nga numri total i respondentëve, 11.7% e të anketuarve e kanë pohuar një gjë të tillë. Arsye të tjera të cilat 5% e respondentëve i kanë dhënë, janë: kushtet e vështira ekonomike të familjes dhe se respondentët janë ndier barrë për familjen.

Si është kurorëzuar martesa juaj?



Figura 6: Si është kurorëzuar martesa juaj?

Në bazë të gjetjeve, pjesa më e madhe e martesave realizohen jashtë procedurave ligjore dhe vetëm një përqindje e vogël e tyre kurorëzohen në institucione komunale. Për këtë fenomen, 59.3% kanë pohuar se janë martuar në mënynë tradicionale. Një pjesë tjetër e konsiderueshme kanë deklaruar se e kanë kryer martesën pa dijeninë e familjeve, kur zakonisht vajzat kanë braktisur familjet e tyre. Në këtë hulumtim, vetëm 12.7% kanë deklaruar se kanë realizuar martesë legale në institucione komunale.

Sipas jush, cila është mosha e përshtatshme për martesë?



Figura 7: Sipas jush cila është mosha më e përshtatshme për martesë?

Moshën 20-25 vjeçare e konsiderojnë si të duhur për martesë, 52.7% e të intervistuarve, kurse, moshën 18-20 vjeçare e shohin si moshën ideale për martesë 19.8% e respondentëve. Moshën 16-18 vjeç e shohin si moshën më të mirë për martesë 14.1 % e të anketuarve. Vetëm 7.7% të respondentëve e shohin si moshë të përshtatshme 14-16 vjeç. Marrë në konsideratë këto përshtypje, del se respondentët janë të vetëdijshëm për moshën ideale për martesë, por që në realitet dhe fatkeqësisht, martesat ndodhin më herët siç tregojnë edhe të dhënat e tabelës 2.

A keni njohuri se ligji e ndalon martesën nën moshën 18 vjeç pa lejen e gjykatës?



Figura 8: A keni njohuri se ligji e ndalon martesën nën 18 vjeç pa lejen e gjykatës?

Nga 300 respondentët që kanë marrë pjesë në këtë hulumtim, 67% e tyre kanë deklaruar se kanë njohuri se ligji e ndalon martesën nën moshën 18 vjeç, kurse 32% e tyre kanë pohuar se nuk kanë informacion se ekziston një ligj i tillë. Siç shihet nga figura 8, femrat janë më të vetëdijshme sa i përket moshës për martesë të lejuar me ligj.

7. Qëllimet e intervistave të thella të Fokus Grupeve dhe studimit të rastit

- Vlerësimi i njohurive të respondentëve mbi moshën ideale për martesë, moshën e lejuar me ligj dhe si ndryshon ky perceptim në bazë të gjinisë së respondentëve
- Krahasimi i lidhjes së martesave të hershme në të kaluarën dhe në kohën e sotme dhe si ndryshon perceptim në bazë të gjinisë
- Vlerësimi i perceptimit të respondentëve të të dy gjinive mbi vendimmarrjen për martesë
- Vlerësimi i ndikimit të rrethit shoqëror dhe komunitetit në paraqitjen e martesave të hershme, me theks ndikimin te vajzat dhe si ndryshon ky ndikim për djemtë
- Vlerësimi i ndikimit të iniciativave dhe fushatave vetëdijësuese për parandalimin e martesave të hershme tek komunitetet e synuara
- Vlerësimi i perceptimit të respondentëve të të dy gjinive për anët pozitive dhe negative të martesave të hershme
- Vlerësimi i njohurive të respondentëve për lidhjen e edukimit dhe martesave të hershme
- Vlerësimi i përshtypjeve të grave të martuara (shumica e të cilave të martuara para moshës 18 vjeç) lidhur me martesat e hershme
- Këndvështrimi i profesionistëve të fushave të ndryshme lidhur me shkaqet e martesave të hershme, shtytësit kryesorë dhe lidhja e këtij fenomeni me statusin social të familjeve
- Marrja e rekomandimeve profesionale për iniciativat që duhet të ndërmerren dhe roli i institucioneve, shoqërisë dhe familjes në parandalimin e martesave të hershme
- Studimi më i thellë i një rasti specifik të martesës së hershme për të kuptuar si ka ndryshuar jeta e respondentes kyçe, këndvështrimet dhe përshtypjet e saj për martesat e hershme, edukimin, ndikimin e rrethit shoqëror
- Vlerësimi i këndvështrimit të personave të afërt të respondentes kyçe (bashkëshorti, vajza, nëna, shoqja dhe mësimdhënësja e saj) dhe përshtypjet e tyre për martesat e hershme dhe jetën e respondentes kyçe

Të gjeturat e intervistave të thella me 20 respondentë (10 femra dhe 10 meshkuj të moshës nga 19 deri 42 vjeç), nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian nga komuna e Fushë Kosovës, përkatësisht Lagjja 28 dhe 29. Respondentët janë zgjedhur me metodën e rastit.

8. Gjetjet kryesore të intervistave të thella

Lidhur me pyetjen se cila moshë është e përshtatshme për martesë dhe pse, si dhe sa ka ndryshuar nga e kaluara fenomeni i martesave të hershme, respondentët meshkuj pohojnë se mosha më e përshtatshme për martesë është 20 deri 25 vjeç, ndërsa respondentet femra mendojnë se mosha ideale për martesë është prej 19 deri 22 vjeç. Shumica e respondentëve mendojnë se ka ndryshime nga e kaluara sa u përket martesave të hershme për shkak se gjeneratat e reja gëzojnë më shumë pavarësi për t'i zgjedhur partnerët e tyre, derisa në të kaluarën martesat janë lidhur në mosha edhe më të reja se 13 vjeç dhe prindërit gjithmonë kanë vendosur se kur dhe me kë duhet të lidhet martesa.

Presioni i rrethit shoqëror ka një impakt të padiskutueshëm te martesat e hershme. Kjo është vërejtur dukshëm kur respondentët janë pyetur se cili është perceptimi i rrethit/ komunitetit lidhur me moshën e duhur për martesë dhe cilat janë qëndrimet e komunitetit për këtë fenomen si për vajzat ashtu edhe për djemtë. Respondentët meshkuj pohojnë se ka qëndrime të ndryshme; gjeneratat e reja preferojnë moshat 20 deri 24 vjeç. Shumë familje preferojnë moshën 20 deri 24 vjeç nëse ka "fjalë të dhënë".

"Fjala e dhënë" nënkupton që familjet preferojnë të bëjnë marrëveshje me familjet tjera që fëmijët/ të rinjtë e tyre të lidhin martesë pasi ta arrijnë moshën e pjekurisë, por që kjo shpesh nuk nënkupton moshën mbi 18 vjeç meqenëse, sipas respondentëve, shumë martesa që lidhen edhe me marrëveshje bëhen edhe nën moshën 18 vjeç. "Fjala e dhënë" mund të vijë edhe si propozim nga dy të rinj të moshës nën 18 vjeç kur ata pëlqehen dhe planifikojnë të martohen më vonë.

90% të respondentëve meshkuj dhe femra mendojnë se komuniteti ka pritshmëri që të rinjtë së pari duhet ta kryejnë shkollimin në mënyrë që të jenë më të përgjegjshëm dhe ta kenë më të lehtë jetën martesore. 10% të respondentëve përmendin edhe presionin negativ të shoqërisë/ komunitetit, kur të rinjtë martohen herët për shkak të perceptimit të rrethit shoqëror. Citat nga respondenti:

"Shpesh rrethi t'bën me shej nëse nuk martohesh n'moshë të re, ata menojnë se je i smutë apo ke ba diçka t'keqe dhe kërkush s'don mu martu me ty."

Respondentet femra janë më mirë të informuara sa i përket moshës së lejuar për martesë sipas ligjit.

Të gjitha respondentet femra kanë pohuar se mosha 18 vjeç është mosha e lejuar me ligj, ndërsa 20% e respondentëve meshkuj mendojnë se martesa mund të lidhet në moshën 16 vjeç. 30% e meshkujve të intervistuar kanë pohuar se mosha për martesë sipas ligjit është 20 vjeç dhe 50% pohojnë se ligji i lejon martesat nga mosha 18 vjeç.

Paragjykimet tek komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian luajnë një rol shumë të rëndësishëm në stigmatizimin e femrave të cilat vendosin të mos martohen, apo të cilat martohen më vonë sesa mosha 20 deri 25 vjeç, moshë kjo e cila shihet si moshë e preferuar për martesë në bazë të hulumtimit. Edhe pse janë raste mjaft të rralla, respondentët meshkuj dhe femra pohojnë se rrethi shoqëror rastet e tilla i etiketon se ato femra nuk i merr askush për disa arsye: po zgjedh shumë dhe do të mbetet pa u martuar, është e sëmurë, nuk mund të lindë fëmijë sepse është e shtyrë në moshë, mbetet barrë e familjes, duan të plaken në shtëpi dhe paragjykime tjera për të cilat respondentëve u vinte vështirë që të shprehen por që nënkuptohej se kanë të bëjnë me çështje të ndershmërisë. Njëra nga respondentet shpjegon se ka raste që femrat nuk martohen sepse duhet të kujdesen për më të vjetrit apo familjarët e tjerë dhe është shumë keq kur edhe këto raste paragjykohen. Gjithashtu, gjeneratat e reja të femrave janë më të pavarura dhe nuk u intereson se çka flet rrethi shoqëror. Shumica e respondenteve femra i përkrahin femrat të cilat janë vendimmarrëse dhe vendosin vetë se kur duhet të martohen. Kjo lidhet edhe me edukimin e femrave të gjeneratave të reja nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian dhe interesimit më të madh të femrave për t'u shkolluar, pavarësuar ekonomikisht dhe për të ndryshuar traditat e familjeve të tyre që lidhen me martesat e hershme.

Në lagjet 28 dhe 29 në Fushë Kosovë organizatat joqeveritare të cilat implementojnë projekte për fuqizimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, shpesh organizojnë fushata vetëdijësuese mbi martesat e hershme. Këto iniciativa shihen si shumë pozitive nga te gjithë të intervistuarit, të cilët pohojnë se duhet të ketë edhe me shumë fushata të tilla, sepse me gjithë përpjekjet e OJQ-ve për vetëdijësimin e komuniteteve të lartëpërmendura, ende ka nevojë për informim edhe më të detajuar. Familjet të cilat jetojnë thellë në lagje, shpesh nuk kanë qasje në ligjerata dhe fushata të tilla dhe në këtë mënyrë mbesin të painformuar. Respondentet femra mendojnë se kryefamiljarëve u duhet përkujtuar më shpesh se martesat e hershme nuk janë të mira për të rinjtë, sepse të rinjtë pastaj përballen me probleme shëndetësore, ekonomike dhe nuk arrijnë që të shkollohen dhe kështu nuk do të mund t'i mësojnë e edukojnë as fëmijët e tyre.

Tradita familjare te komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian lidhur me vendimmarrjen për moshën e duhur për martesë është përcjellë edhe në ditët e sotme. Të gjithë respondentët pohojnë se në kohët e kaluara vendimet i kanë marrë gjyshërit apo kryefamiljari mashkull më i vjetër në familje. Me kalimin e kohës, vendimet i ka marrë kryefamiljari, ndërsa në ditët e sotme ka përmirësim të

dukshëm sepse më së shpeshti vendimin për moshën e duhur për martesë të fëmijëve të tyre e marrin të dy prindërit së bashku.

Të pyetur se cilat janë anët pozitive dhe negative të martesave të hershme, të intervistuarit kanë renditur faktorët si në tabelën më poshtë.

Anët pozitive dhe negative të martesave të hershme

Pozitive	**Negative**
Lindja e fëmijëve (prindërimi)	Përgjegjësi shtesë
Rehatimi (martesa në familje të mirë)	Ndërprerja e shkollimit
Përshtypja se vajza nuk është më barrë e familjes	Shtatzëni e hershme
Marrja e nuses nënkupton më shumë ndihmë për familjen e burrit (punë fizike, mirëmbajtje, kujdes për të moshuarit dhe fëmijët)	Shtimi i numrit të divorceve
	Probleme shëndetësore fizike dhe psikologjike
	Varfëri/ vështirësi ekonomike
	Aborti

Edukimi lidhet shumë ngushtë me martesat e hershme. Këtë e tregon edhe hulumtimi i mëhershëm i realizuar nga organizata "The Ideas Partnership" në vitin 2017[7]. Ky hulumtim adresoi një nga sfidat kryesore të kohezionit social me të cilat përballen komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian të Fushë Kosovës - manifestimi i pabarazisë gjinore në martesat e hershme që i lë vajzat jashtë arsimit dhe larg rrjeteve të tyre mbështetëse. Rritja e numrit të viteve të kaluara në shkollë ka përfitime për punësimin dhe për rrjedhojë stabilitetin ekonomik dhe shëndetin. Hulumtimi ynë tregon se martesa shënon fundin e edukimit, kështu që fenomeni i martesës së hershme dhe edukimit janë të lidhura ngushtësisht.

Lidhur me pyetjen se si ndikojnë martesat e hershme në edukim, të gjithë respondentët mendojnë ngjashëm, duke theksuar se martesat e hershme shpiejnë drejt ndërprerjes së shkollimit. Fëmijët e prindërve të pashkolluar po ashtu i vuajnë pasojat, sepse këta prindër nuk janë shembuj të mirë për fëmijët e tyre dhe gjithashtu prindërit hasin vështirësi për t'i ndihmuar fëmijët gjatë shkollimit. Kjo vërehet që në moshë të hershme, sepse prindërit e pashkolluar nuk kanë se çka të transmetojnë te fëmijët e tyre, përvec dashurisë dhe kujdesit, me aq sa dinë dhe kanë mundësi. Për më tepër, respondentët pohojnë se martesa sjell obligime dhe përgjegjësi të reja, kështu që shkollimi i nënave dhe baballarëve stopohet dhe prindërit më me rëndësi e kanë që ta sigurojnë jetesën për fëmijët e tyre, sesa të shkollohen vetë.

[7] http://theideaspartnership.org/wp/?page_id=701

9. Fokus Grupet

9.1 Përmbledhje e Fokus Grupit me vajza

Gjithsejt: 7 vajza të moshës prej 13 deri 17 vjeç, të gjitha i përkasin komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian dhe janë banore të Fushë Kosovës.

".....edhe nëse nuk punsohesh mas shkollimit, mjafton me kanë e edukume dhe e shkollume sepse mandej ki ma shumë zgjedhje në jetë, vendimet i merr vetë ma lehtë, je shembull i mirë për qikat tjera të reja dhe i edukon ma mirë fmitë e tu."

3 nga vajzat kanë të kryer vetëm dy vjet shkollim, 3 kanë të kryer shkollën fillore dhe 1 vijon shkollën e mesme.

Shumica e prindërve të vajzave janë të papunë, megjithatë ata angazhohen ndonjëherë në punë ditore, merren pak me bujqësi apo punë krahu në treg.

Qëllimi i këtij Fokus Grupi ka qenë që të merren mendimet dhe perceptimet e vajzave të reja lidhur me shkaqet e martesave të hershme. Të gjitha pjesëmarrëset pajtohen se mosha ideale për martesë është mbi 20 vjeç, meqenëse e konsiderojnë këtë moshë si më të pjekur për të marrë vendime. Vendimet për martesa në familjet e tyre merren më shumë nga prindërit, por që zakonisht merret edhe mendimi i vajzave. Situata e tanishme dallon nga gjeneratat e kaluara, ku pjesëmarrëset tregojnë për nënat dhe gjyshet e tyre të cilat jo vetëm që janë martuar në moshë të re, por që bashkëshortin ua ka zgjedhur kryefamiljari dhe janë martuar pa u parë me burrin e tyre të ardhshëm. Vajzat në mënyrë të theksuar shpjegojnë se edhe në ditët e sotme femrat nuk trajtohen njëjtë si meshkujt sa u përket martesave të hershme. Ato mendojnë se vajzat dhe djemtë duhet të trajtohen njëjtë, sepse nëse një vajzë nuk martohet "me kohë", atëherë ka paragjykime, përderisa te meshkujt kjo ndodh më rrallë.

Të gjitha vajzat janë të vetëdijshme se, me ligj, mosha e lejuar për martesë është mbi 18 vjeç dhe pohojnë se prindërit shpesh i këshillojnë që ta vazhdojnë shkollimin dhe që të mos martohen herët, por që ka mjaft raste kur vajzat braktisin shkollën, nuk i dëgjojnë prindërit dhe martohen herët pa lejen e prindërve. Kështu, ato nuk gëzojnë përkrahjen e familjes së tyre, përderisa në shtëpi të burrit i pret tjetër jetë, tjera përgjegjësi dhe në këtë mënyrë ato mbesin të pashkolluara dhe nuk janë të përgatitura që të bëhen nëna, e as që dinë t'i menaxhojnë punët e shtëpisë.
Asnjë nga vajzat nuk sheh asnjë anë pozitive te martesat e hershme dhe pohojnë se martesa e hershme është bllokim i jetës dhe mundësisë për pavarësim dhe edukim. Ato e shohin edukimin si shumë të rëndësishëm për jetën e tyre, edhe pse në kohët e sotme punësimi është i vështirë edhe pas kryerjes së shkollës, por që emancipimi i femrave ka shumë rëndësi për jetën e tyre sepse kështu ndërron edhe statusi i tyre shoqëror.

Citim nga respondentja*:*

".....edhe nëse nuk punsohesh mas shkollimit, mjafton me kanë e edukume dhe e shkollume sepse mandej ki ma shumë zgjedhje në jetë, vendimet i merr vetë ma lehtë, je shembull i mirë për qikat tjera të reja dhe i edukon ma mirë fmitë e tu"!

Iniciativat për parandalimin e martesave të hershme, pjesëmarrëset e Fokus Grupit i shohin si shumë të qëlluara, por që duhet të jenë më të shpeshta në mënyrë që shoqëria të vetëdijësohet më shumë.

Gjatë bisedës vajzat në përgjithësi janë ndier mirë për të diskutuar mbi të drejtat e tyre dhe ndikimin e shkollimit në jetën e tyre. Ato, edhe pse mjaft të reja në moshë, ndjejnë keqardhje për prindërit e tyre, shumica e të cilëve nuk kanë as shkollim të mesëm dhe kryesisht janë të papunë. Marrë parasysh gjendjen e tyre ekonomike dhe diskriminimit që u bëhet në familje, shkollë apo institucione tjera, ato prapë kanë vizion për të ardhmen e tyre dhe shpëtimin e shohin tek shkollimi dhe më pas te punësimi.

Sipas vajzave shkaqet kryesore të martesave të hershme janë:

- diskriminimi ndaj vajzave në shtëpi, shkollë dhe shoqëri
- braktisja e shkollimit
- varfëria
- mungesa e informacioneve dhe
- mentaliteti i shoqërisë/ komunitetit

9.2 Përmbledhje e Fokus Grupit me djem

Gjithsejt: 5 djem të moshës prej 15 deri 19 vjeç, të gjithë i përkasin komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian dhe janë banorë të Fushë Kosovës. Shumica e prindërve të djemve nuk janë duke punuar, apo mbijetojnë duke mbledhur materiale të reciklueshme.

Djemtë pjesëmarrës të këtij Fokus Grupi kanë të kryera 5 deri në 8 vjet shkollim dhe tre prej tyre herë pas here angazhohen në punë ditore. Asnjëri nga ta nuk është i martuar. Ata kanë pranuar me kënaqësi që të marrin pjesë në një diskutim për martesat e hershme dhe pohojnë që biseda të tilla duhet të realizohen më shpesh.

Gjatë bisedës, djemtë nuk janë ndier rehat që të diskutojnë mbi çështje të caktuara, posaçërisht për pasojat e martesave të hershme te djemtë dhe kur janë diskutuar çështje mbi percptimin e shoqërisë për vajzat të cilat nuk martohen herët. Megjithatë, djemtë ishin të entuziazmuar për të biseduar rreth të drejtave të tyre për të marrë vendime dhe për të folur mbi traditat familjare që lidhen me martesat e hershme.

Lidhur me pyetjen se cila moshë është e përshtatshme për martesë, të gjithë djemtë kanë pohuar se është mbi 18 vjeç, për shkak se kur je më i pjekur i kupton gjërat më mirë, ke mundësi që të punësohesh dhe ta mbash familjen. Gjithashtu, ata mendojnë se vendimet mund t'i marrin më shumë vetë pas moshës 18 vjeç sesa të vendosin prindërit për ta. Djemtë janë të bindur se shoqëria/ komuniteti ku jetojnë presin që vajzat të martohen më herët se djemtë dhe kjo vlen për martesat para moshës së pjekur dhe pas moshës së pjekur. Megjithatë, është pak më ndryshe perceptimi për djemtë sepse në komunitet djemtë gëzojnë më shumë të drejta. Ata janë mjaft të vetëdijësuar se vajzat që martohen herët nuk kanë mundësi ta vazhdojnë shkollimin, sepse duhet të kujdesen për shtëpinë dhe fëmijët, ndërsa djemtë nuk është se kanë shumë obligime përveç që duhet ta sigurojnë jetesën e që për një person të pashkolluar kjo është mjaft e vështirë.

Ngjashëm me Fokus Grupin me vajzat, edhe djemtë pohojnë se vendimet për moshën e duhur për martesë, i marrin prindërit në bashkëpunim me fëmijët e tyre, por që djemtë kanë më shumë liri për të vendosur. Të pyetur se si i bën të ndihen kjo liri më e madhe e djemve për të zgjedhur moshën për martesë, krahasuar me motrat apo shoqet e tyre, djemtë ndjejnë keqardhje që ka dallime të tilla. Ata tregojnë se si kjo gjendje është duke ndryshuar me kohën e modernizimit por që është duke shkuar shumë ngadalë.

Traditat familjare të komunitetit ku pjesëmarrësit e këtij diskutimi jetojnë, janë duke pësuar ndryshime pozitive. Ata tregojnë se si vajzat që ndjekin shkollimin dhe janë të punësuara, shihen me admirim (adhurim) në komunitet dhe në shoqëri. Sikurse te diskutimi me vajzat, edhe djemtë kanë përgjigjje të ngjajshme për lidhjen e martesave të hershme dhe edukimit. Ata pajtohen se martesat e hershme sjellin shumë përgjegjësi për të cilat të rinjtë mendojnë se janë gati, por që nuk janë në realitet dhe kjo situatë shpesh shpie te divorci, proces ky që sjell edhe më shumë probleme sepse shoqëria pastaj i paragjykon dhe kjo nuk i bën të ndihen mirë.

Iniciativat për parandalimin e martesave të hershme janë shumë të mireseardhura sipas djemve, madje ata mendojnë se është më e rëndësishme që djemtë ta kuptojnë se martesat e hershme nuk kanë asnjë anë pozitive.

Citat nga pjesëmarrësi i diskutimit:

"...shpesh djemt menojnë se nëse martohen heret, kan me pasë jetën ma t'mirë, kan me kriju familje! Por kjo del krejt ndryshe, sepse djemt e ri zakonisht nuk janë të pregaditun me marrë përgjegjësi e me majtë familje, e mandej zhgënjehen, divorcohen, shkojnë rrugëve të këqija [duke nënkuptuar këtu keqpërdorimi me substanca narkotike, alkool, përfshirje në akte kriminale etj.]"

Sipas djemve shkaqet kryesore të martesave të hershme janë:

- mungesa e shkollimit dhe punësimit edhe e të rinjve edhe e prindërve
- gjendja e keqe ekonomike
- mosvetëdijësimi i të rinjve dhe
- deri diku traditat familjare

9.3 Përmbledhje e Fokus Grupit me gratë

Gjithsejt: 10 gra të moshës prej 33 deri 61 vjeç, të gjitha i përkasin komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian dhe janë banore të Fushë Kosovës.

"....hala pa e ditë mirë trupin tem, m'kanë martu edhe shumë shpejt jam ba nanë! Familja e burrit kanë pritë që unë m'i kry krejt punt e shpisë, me gatu, me fshi, me rritë fmi..... po unë isha vetë fmi diqysh"!

Shumica e grave që kanë marrë pjesë në diskutim janë martuar nën moshën 18 vjeç dhe ka qenë mjaft interesante që të marrim përshtypjet e tyre lidhur me shkaqet e martesave të hershme. 8 prej tyre kanë të kryer vetëm katër deri gjashtë vjet shkollim, ndërsa 2 prej tyre nuk kanë shkuar kurrë në shkollë.

Lidhur me pyetjen për moshën e përshtatshme për martesë, të gjitha gratë pajtohen që mosha më e mirë është pas moshës 18 vjeç; disa gra specifikisht preferojnë martesat prej 24 deri 27 vjeç meqë ato vetë janë martuar të reja dhe i kanë vuajtur pasojat e martesës së hershme. Gratë janë të lumtura se kanë krijuar familje dhe kanë fëmijë, por që nëse do të mund ta ndryshonin këtë realitet ato nuk do të martoheshin kurrë aq të reja. Ato flasin lirshëm për problemet që i kanë pasur si nuse të reja.

Citat nga respondentja:

"....hala pa e ditë mirë trupin tem, m'kanë martu edhe shumë shpejt jam ba nanë! Familja e burrit kanë pritë që unë m'i kry krejt punt e shpisë, me gatu, me fshi, me rritë fmi.....po unë isha vetë fmi diqysh edhe kam pasë shumë probleme me burrin se edhe ai ish veç dy vjet ma i vjetër se unë.....me mujtë me kthy kohën, nuk isha martu qaq e re!"

Edhe pse me pak vite shkollim, gratë janë të vetëdijshme që ligji nuk i lejon martesat nën moshë dhe i këshillojnë fëmijët e tyre që të mos e përsërisin këtë gabim. Megjithatë, theksojnë se shpesh fëmijët mashtrohen nga dashuria dhe martohen pa lejen e prindërve. Sa i përket perceptimit të komunitetit se cila është mosha e duhur për martesë dhe si shihen vajzat të cilat nuk martohen herët, gjatë diskutimin hasim në përgjigjje të ndryshme. Gratë thonë se komuniteti paragjykon shumë nëse vajzat mbushin, le të themi 25 vjeç dhe nuk martohen, por që kur shohin shembuj të

mirë të vajzave e grave që shkollohen e punësohen ata i përgëzojnë. Kështu që gratë preferojnë që të rinjtë të mos bien pre e paragjykimeve të shoqërisë, por të shohin drejt së ardhmes së tyre; të shkollohen, të punësohen e pastaj të mendojnë për martesë. Në pyetjen se si do të vepronin gratë nëse fëmijët e tyre martohen para moshës 18 vjeç, ato pohojnë se mundohen shumë që ta parandalojnë këtë gjë, por ndodh që fëmijët të mos dëgjojnë dhe këtë faj ia lënë mungesës së shkollimit të prindërve.

Citat nga respondentja;

"Dikush që nuk ka krye vetë shkollë, as nuk din qysh me eduku fmin e vet"!

Sa i përket ndikimit të martesave të hershme në gjendjen ekonomike, gratë rrëfejnë shembuj të ndryshëm nga komuniteti dhe të afërmit e tyre rastet kur familja i marton djemtë më herët në mënyrë që të sjellë nuse në shtëpi e cila do të ndihmojë në punët e shtëpisë dhe do të lindë pasardhës, por që kjo sjell edhe probleme ekonomike sepse pastaj ka më shumë gojë për të ushqyer. Në kohët e mëparshme vendimet për martesë i kanë marrë pleqtë, pra më të vjetrit e familjes, marrë parasysh që familjet e gjëra kanë jetuar në bashkësi, vendimet për martesën e nipave dhe mbesave i kanë marrë gjyshërit, xhaxhallarët etj. Ndërsa tash vendimet i marrin zakonisht prindërit së bashku me femijët, por ka raste mjaft të shpeshta që fëmijët nuk pyeten fare. Përgjigje interesante kemi marrë nga një respondente e cila nuk ka shkuar kurrë në shkollë dhe ka qenë vetëm 13 vjeç kur është martuar. Ajo i sheh si pozitive martesat e hershme dhe pohon se shkolla vajzave nuk u duhet, duke aluduar se vajzat në shkollë nuk mësojnë asgjë dhe se ato duhet që të krijojnë familje sa më shpjet e të kenë pasardhës. Ajo tregon se si burri i saj ka qenë 17 vjeç kur janë martuar dhe ai para se të martohej ka bredhur rrugëve, ndërsa sapo është martuar, është bërë më i përgjegjshëm dhe del çdo ditë të gjejë punë për t'i siguruar të ardhurat e familjes. Megjithatë, respondentja në fjalë thotë se vajzat e saj nuk do t'i martonte aq herët sa është martuar ajo, por gjithsesi rreth moshës 20 vjeç.

Pjesëmarrëset e këtij diskutimi janë të bindura se shkaqet kryesore për martesat e hershme janë:

- mungesa e shkollimit
- gjendja ekonomike
- papjekuria e të rinjve dhe
- dëshira e prindërve për t'i "rehatuar" fëmijët e tyre të cilët në mungesë të shkollimit dhe vetëdijësimit nuk mendojnë shumë për pasojat shëndetësore dhe jetësore që sjellin martesat e hershme

9.4 Përmbledhje e Fokus Grupit me profesionistë të fushave të ndryshme

Gjithsejt: 9 profesionistë të fushave të ndryshme si Sociologji, Psikologji, Mjekësi, Menaxhment, Ekonomi, Juridik, Studime Gjinore, Mësimdhënie dhe Punë Sociale.

"Vajza është për derë të huaj"

Lidhur me pyetjen se cilat janë shkaqet kryesore të martesave të hershme te komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian, pjesëmarrësit e këtij Fokus Grupi i cili ka përvojë të gjatë me hulumtime të ndryshme që bëhen për gjendjen e komuniteteve në fjalë mendon se një prej arsyeve kryesore lidhet me jetëgjatësinë e pjesëtarëve të këtyre komuniteteve. Një hulumtim i realizuar nga Balkan Sunflowers në vitin 2015[8], tregon që komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian si një grup në këtë rast, kanë një mesatare të jetëgjatësisë rreth 12 vjet e gjysmë më pak ose më të shkurtër sesa komuniteti shumicë. Rezultatet e hulumtimit në fjalë që ka mbuluar edhe banorët e fshatit Plemetin, tregojnë se martesat e hershme ndodhin sepse familja dëshiron që të arrijë t'i shohë nipat dhe mbesat, pasi jo shumë prej tyre jetojnë më shumë se 57 vjet duke e lidhur këtu shkakun e martesave të hershme direkt me traditën familjare.

Sociologët pohojnë se problemi kryesor është gjendja ekonomike, por që e lidhin jetëgjatësinë edhe me stilin e jetesës, sepse komunitetet në fjalë jetojnë kryesisht në kushte të rënda ekonomike dhe punët që i bëjnë për jetesë janë punë të rënda fizike, prandaj kjo edhe e determinon jetëgjatësinë e tyre.

Një fakt interesant përmendet edhe nga profesionistët e studimeve gjinore të cilët pohojnë se shkaqet e martesave të hershme lidhen shume me moralin. Si te komunitetet shumicë si tek ato pakicë, në shoqërinë tonë morali është gjëja kryesore e cila shpie te martesat e hershme. Prindërit e të gjitha komuniteteve, pa dallim, posaçërisht prindërit që nuk kanë shkollim të lartë, kanë frikë se fëmijët e tyre do të marrin rrugë të këqija dhe ky presion i shtyn që t'i orientojnë fëmijët e tyre, posaçërisht vajzat kah martesa. Kjo është pothuajse e njëjtë sikur të dëshirojnë që ta ruajnë nderin e familjes, por që te komunitetet pakicë kjo vërehet më shumë, e që është dukshëm i shprehur edhe te komunitetet shumicë që jetojnë kryesisht në pjesët rurale. Pra, shkaqet e martesave të hershme nuk burojnë vetëm nga gjendja ekonomike apo mungesa e shkollimit, por edhe nga çështjet morale kur prindërit e shohin më të arsyeshme që të "mbarojnë punë" dhe t'i rehatojnë fëmijët e tyre.

Psikologët dhe profesionistët nga fusha e studimeve gjinore, pohojnë se diskriminimi po ashtu luan rol të rëndësishëm sepse dukshëm djemtë favorizohen për arsye të cilat i hasim edhe te komuniteti shumicë. Hulumtimet tregojnë se prindërit më përpara e shkollojnë djalin sesa vajzën, sepse djali sjell të hyra në shtëpi, ndërsa vajza është " për derë të huaj". Hulumtuesit e pranishëm në fokus

[8] http://balkansunflowers.org/images/stories/pdf/kosana%20annual%20report_2015_web.pdf

grup tregojnë edhe për temën tabu për të cilën vështirë se mund të flitet me pjesëtarët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, e ajo është çështja e "pazarit" që bëhet në mes të familjeve. Shumica e pjesëmarrësve të Fokus Grupit pohojnë se kanë dëgjuar për këtë fenomen i cili nuk përmendet pothuajse në asnjë hulumtim tjetër. Mirëpo, ky lloj " pazari për martesë" haset edhe te komuniteti shumicë dhe paraqet një problem të madh, përderisa nuk diskutohet sepse është e turpshme. Çështja e pazarit për martesë është praktikë edhe në vende të ndryshme të botës, por që në shoqërinë kosovare ende nuk është trajtuar, e as hulumtuar sa duhet. Juristja e pranishme në diskutim pohon se në një formë kjo është shitje e fëmijës dhe mund të konsiderohet si keqpërdorim, trafikim i qenieve njerëzore dhe personat që shesin fëmijët e tyre, posaçërisht ata që janë nën moshën e pjekurisë mund të dënohen ashpër me ligj.

Ky fenomen pastaj ngreh edhe vegzën e grabitjes së nuses, - pohojnë pjesëmarrësit, shumica e të cilëve kanë realizuar hulumtime me vite të tëra lidhur me jetesën dhe problemet me të cilat përballen komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Në rastet kur familja e djalit nuk ka mundësi që të paguajë për marrjen e nuses, shpesh djali e grabit nusen dhe e sjell në shtëpi, kështu familja " shpëton" nga pagesa, por që problemet vazhdojnë sepse familjet pastaj mund të bien në hasmëri me njëra-tjetrën.

Punëtori social thekson se edhe rrethi shoqëror ndikon thellë në paraqitjen e martesave të hershme. Familjet, duke parë rrethin e tyre se si i martojnë vajzat herët, e posaçërisht 20 vitet e fundit se si vajzat martohen në diasporë dhe më pas i ndihmojnë familjet e tyre, ka bërë të vetën dhe ka shtyrë që edhe familjet tjera të ndikohen dhe të veprojnë njëjtë duke i martuar fëmijët sa më herët në mënyrë që të sigurjnë një burim të të ardhurave.

Se si lidhet ky fenomen me statusin social të pjestarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të dhënat e Fokus Grupit tregojnë se shumë familje për të ardhur deri te përfitimi i asistencës sociale, i martojnë djemtë dhe vajzat në moshë të re, në mënyrë që ata të krijojnë sa më shpejt familje dhe fëmijë që më pas t'i plotësojnë kriteret për asistencë sociale.
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në ligjin për skemën e ndihmës sociale në Kosovë thotë se ti mund të përfitosh ndihmë sociale nga shteti nëse i përmbush kriteret vijuese jofinanciare: ...nëse një anëtar i familjes është i aftë për punë, por është një fëmijë në familjen tënde që është më i vogël se 5 vjeç[9]. Andaj, këtu do të duhej të reflektojnë edhe institucionet relevante të nivelit lokal dhe qendror, në mënyrë që të ndryshojnë kriteret e përfitimit të asistencës sociale.

Psikologu pohon se një tjetër shkak për prezencën e martesave të hershme është edhe mungesa e raporteve të shëndosha prind-fëmijë dhe kjo vlen për mbarë shoqërinë, pa dallim të komuniteteve. Fëmijët duke mos diskutuar me prindërit e tyre, në moshën e pubertetit apo adoleshencës, janë më të prirur të ndikohen nga shoqëria, shembujt në komunitetin ku jetojnë dhe më pak të prirur të

[9] https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2826

bisedojnë me prindërit. Kjo ndodh edhe për shkak të kulturës në familjet tona dhe te të gjitha komunitetet ku nuk diskutohen temat që janë ende tabu, atëherë pasojat vijnë pa u ndalur. Andaj, martesat e hershme të cilat ndodhin te të gjitha komunitetet, lidhen ngushtë me mungesën e komunikimit të mirëfilltë në mes të fëmijëvë dhe prindërve. Për më tepër, prindërit e pashkolluar shpesh nuk dinë si t'u qasen fëmijëve të tyre, andaj shumë tema të rëndësishme mbesin pa u diskutuar. Aspekti socio-ekonomik normalisht që është më i rëndësishmi, por që përkrahja e prindërve për fëmijët e tyre dhe komunikimi mungon tek të gjitha komunitetet ku shfaqen martesat e hershme.

Një pjesëtare e Fokus Grupit e cila ka përvojë në edukim dhe menaxhim të projekteve për integrimin e komuniteteve pakicë, pohon se martesat e hershme assesi nuk mund t'i trajtojmë si fenomen karakteristik për komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian. Në pjesët rurale të Kosovës fatkeqësisht vajza shihet si një objekt i cili do të lindë fëmijë, do të gatuajë dhe do të pastrojë. Ende hasim familje që thonë se "vajza është për derë të huaj"; pra që nga fillimi vjazat trajtohen si mjet për riprodhim, fuqi punëtore dhe se nuk përket në familjen e saj, por të burrit të cilin do ta marrë.

Shumë familje nga të gjitha komunitetet ende u besojnë miteve se femra më e vjetër në moshë mund të mos lindë fëmijë, ose mund të lindë fëmijë me probleme shëndetësore.

Citat i respondentes*:*

"Shoqëria jonë ende e shohin një vajzë 25 vjeçare si vajzë që i ka kalur koha, që i ka ikur treni biologjik për të lindë fëmijë! Për këtë arsye edhe janë prezente martesat e hershme."

Tutje, është fatkeqësi që martesat e hershme dallohen më lehtë tek komunitetet pakicë, ndërsa mbahen si tema tabu te komuniteti shumicë.

Juristja pohon se edhe standardi i dyfishtë i institucioneve për t'i trajtuar martesat e hershme luan rol shumë të rëndësishëm. Duke pasur një shtet ku ligji nuk funksionon si duhet, atëhere as gjyqtarët e as prokurorët nuk e kryejnë punën e tyre si duhet. Rastet nuk lajmërohen, por edhe po të lajmërohen procedurat zgjaten aq shumë sa që edhe harrohen dhe ndërkohë të rinjtë mbushin moshën e pjekurisë.

Lidhur me masat ligjore që duhet të merren në rastin e martesave të hershme, të dhënat nga diskutimi tregojnë se intervenimi me kohë i Qendrës për Punë Sociale dhe zbatimi i kornizës ligjore, janë dy aksione kryesore që duhet të merren. Shoqëria në përgjithsësi duhet të vetëdijësohet dhe të informohet për pasojat e këtij fenomeni. Funksionimi efektiv i ligjit do të mund ta ulte numrin e martesave të hershme, meqë ato përbëjnë shkelje të ligjit. Përfshirja e pjestarëve të të gjitha komuniteteve në iniciativa për parandalimin e martesave të hershme do të ishte po ashtu një hap i duhur. Ekzistojnë edhe masa tjera alternative për lajmërimin e braktisjes së shkollës dhe lidhjes së

martesave të hershme, siç janë: mobilizimi i komunitetit për të lajmëruar dukuritë e tilla në shkëmbim të shpërblimit, penalizmi i policisë dhe institucioneve tjera relevante në rast të mos-intervenimit pas lajmërimit të rasteve apo iniciativa me pjesëtarët e komuniteteve të cilët janë të shkolluar.

Martesat e hershme te vajzat kanë ndikim të madh në rrezikimin e shëndetit. Shtatzënësitë e padëshirueshme, komplikimet e ndryshme gjatë shtatzëniisë, abortet, sëmundjet seksualisht të trasnmetueshme, infeksionet dhe problemet tjera shëndetësore vijnë nga mungesa e njouhurive për planifikimin familjar. Ky problem buron edhe nga mungesa e lëndës mbi edukimin seksual nëpër shkolla dhe kjo i lë të rinjtë të painformuar si duhet. Profesionistët nga fusha e Studimeve Gjinore pohojnë se të rinjtë më shumë preferojnë që këto informata t'i marrin nga shoqëria dhe interneti, sesa nga prindërit, meqë në shoqërinë kosovare ka shumë tema tabu për të cilat vështirë flitet brenda familjes. Andaj, informimi i të rinjve mbi edukatën seksuale është shpesh i limituar dhe i gabuar, meqë informacioni nuk merret i plotë dhe nuk kuptohet mirë nga të rinjtë. Zgjidhja më e mirë do të ishte që shkollat ta kenë edukatën seksuale si lëndë, ku të rinjtë do të mund të informoheshin dhe vetëdijësoheshin së pari për fiziologjinë e trupit të tyre, seksin, mjetet kontraceptive dhe metodat tjera parandaluese, sëmundjet seksualisht të transmetueshme, HIV-in dhe shumë faktorë të tjerë të cilët do t'i përgatisnin ata për të ardhmen. Për më tepër, profesionisti nga fusha e shëndetësisë pohon se sipas statistikave, vajzat që lindin herët kanë shanse më të mëdha që të kenë shtatzënësi dhe lindje të komplikuara, lindje të parakohshme dhe depresion të paslindjes. Kjo vjen edhe si rezultat i papërgatitjes së tyre për prindërim, aq më tepër kur as partneri nuk di si ta përkrahë sepse edhe ai është në moshë të re dhe është i papërgatitur për t'u bërë baba. Ky reaksion zinxhir shpie edhe te problemet psiqike të të dy prindërve të cilët janë të rinj në moshë dhe shpesh përfundojnë me divorc.

Të gjithë pjesëmarrësit e këtij Fokus Grupi pajtohen që organizimi i aktiviteteve të vetëdijësimit mbi martesat e hershme në qytete dhe posaçërisht në zona të thella rurale dhe avokimi në institucione për implementimin e ligjeve përkatëse që parandalojnë martesat e hershme, kanë rëndësi jetike për të zvogëluar numrin e paraqitjes së këtij fenomeni. Shkollat, qendrat e mësimit dhe qendrat rinore, organizatat joqeveritare dhe institucionet lokale e qendrore mund të bëjnë punë më efektive në mënyrë që t'i parandalojnë martesat e hershme dhe t'i informojnë më shumë të rinjtë lidhur me pasojat që sjell ky fenomen.

Shkaqet e martesave të hershme sipas këtij Fokus Grupi janë; aspekti ekonomik, ruajtja e nderit, jetëgjatsia e shkurtër dhe "pazari" që bëhet ndërmjet familjeve me rastin e një martese.

9.5 Gjetjet kryesore të Fokus Grupeve

Diskutimet e Fokus Grupeve tregojnë se aryset kryesore të martesave të hershme janë: gjendja e vështirë ekonomike, mungesa e shkollimit të të rinjve dhe prindërve, braktisja e shkollës, traditat familjare, ruajtja e nderit, papjekuria e të rinjve dhe dëshira e prindërve për t'i "rehatuar" fëmijët, papunësia, mungesa e informimit dhe vetëdijësimit të të rinjve dhe komunitetit për pasojat që sjellin martesat e hershme, paragjykimet e shoqërisë dhe komunitetit, diskriminimi ndaj vajzave.

10. Studimi i Rastit

Me qëllim që të hulumtohet edhe më thellë fenomeni i martesave të hershme, është realizuar edhe një studim i rastit, ku hulumtuesit kanë përzgjedhur një grua e cila është martuar herët. Në këtë studim rasti është intervistuar gruaja si respondenti kyç, bashkëshorti, vajza dhe nëna e saj si dhe mësuesja e saj tek e cila respondentja kyçe ndjek mësimet shkrim-lexim për të rritur dhe ato të prindërimit në qendrën e mësimit dhe komunitetit të organizatës "The Ideas Partnership" në Fushë Kosovë. Për arsye të etikës së punës, respondenten kyçe e kemi quajtur "Lule".

Lulja është grua 21 vjeçare dhe ka tre fëmijë. Ajo jeton në Fushë Kosovë në një shtëpi të vjetër me pjesën tjetër të familjes së burrit dhe në kushte mjaft të vështira ekonomike. Lulja nuk ka shkuar kurrë në shkollë. As motrat dhe vëllezerit e saj nuk janë shkolluar. Prindërit e saj poashtu nuk kanë shkuar kurrë në shkollë. Lulja ishte vetëm 14 vjeç kur u martua.

"Prindërit më kanë dhanë.....unë s'kam marrë kurrfarë vendimi. Burrin e kam njoftë dhe e kam dashtë",- thotë ajo me buzëqeshje teksa kujton ditën e saj të martesës. Bashkëshorti i saj në atë kohë ishte 16 vjeç. Sipas traditës, familja e burrit e ka dërguar mësitin te familja e Lules dhe me pajtimin e prindërve të saj dhe të burrit, është marrë vendimi për martesë.

"Çka kam ditë unë atëhere? Kurgjo hiq s'kam ditë...veq që krejt qikat qashtu të reja u martojshin, se tani thojnë të ik vakti e met te shpija e babës, as s'mun me lindë fëmijë as kurgjo....." rrëfen Lulja, duke shpjeguar se ka qenë shumë e re dhe e papregaditur për jetë bashkëshortore, e aq më pak për t'u bërë nënë. Ajo thotë se në fillim e ka pasur shumë të vështirë që të adaptohet në shtëpinë e burrit. Tregon se si i është dashur që të punojë shumë për mirëmbajtje të shtëpisë dhe me gjithë ndihmën e vjehrrës së saj, ajo ka qenë shumë e re për ta përballuar menaxhimin e punëve të shtëpisë, shtatzënësinë, lindjen e fëmijëve një pas një dhe duke shtuar këtu edhe gjendjen e vështirë ekonomike, jeta e saj mori kahje tjetër.
".....mu dok që përnihere u bana zojë shpije, grue, prind e krejt....boll fshtirë e kam pasë se kushtet e kqija, kur s'je vet n'punë, kur s'punon burri, fshtirë është"!

Lulja mendon se mosha ideale për martesë është mbi 20 vjeç, sepse atëherë je më e pjekur dhe më e përgatitur për martesë. Tutje shton se koha e tanishme është më ndryshe sesa në të kaluarën sepse prindërit tani mendojnë ndryshe për vajzat e tyre. Shpesh gjatë bisedave me shoqet e saj, diskutojnë se sa e rëndësishme është që vajzat të shkollohen e të punësohen në mënyrë që të pavarësohen dhe të mos varen nga burrat e tyre. Ajo është e vetëdijshme se mosha e lejuar për martesë është 18 vjeç, por që sikur të pyetej ajo, kjo moshë edhe me ligj do të duhej të ishte 20 vjeç. E pyetur se a ka paragjykime për vajzat të cilat nuk martohen herët dhe a ndryshon ky qëndrim për djemtë, ajo pohon se fjalët e njerëzve nuk ndalen kurrë, shoqëria gjithmonë paragjykon, posaçërisht femrat. Ndërsa për djemtë nuk ka njohuri. Ajo thotë se nuk i intereson se çfarë qëndrimesh ka shoqëria për djemtë që nuk martohen herët,

por që është e sigurtë se vajzat e kanë më të vështirë dhe shpesh i vuajnë pasojat e këtyre paragjykimeve. Lulja brengoset për të rinjtë sepse sipas saj nuk po mund të gjindet një mes i artë, në mes së shkuarës dhe së tashmes. ***"Përpara fmit si ka vet kërkush, prindërit kanë vendos për ta për martesë, e tash fmit nuk të vetin, edhe kur ju jep këshilla që mos mu martu heret, ata shpesh nuk ngojnë....shkojnë mas qefit të vet!"*** – thotë ajo.

Asnjëra nga këto ekstreme nuk i pëlqen Lules. Ajo thotë se nuk do të donte që fëmijët e saj të martoheshin herët sepse pastaj problemet vijnë pa ndalur. Iniciativat për parandalimin e martesave të hershme ajo i sheh si shumë pozitive dhe të qëlluara. Meqë Lulja nuk është shkolluar, ajo i ndjek rregullisht aktivitetet për shkrim – lexim për të rritur dhe ato të prindërimit në qendrën e mësimit dhe komunitetit të organizatës "The Ideas Partnership" në Fushë Kosovë. Asaj i pëlqen shumë që të shoqërohet me gra të tjera ku së bashku mësojnë dhe kalojnë kohë të mirë. Ajo jo vetëm që e ka mësuar shkrimin dhe leximin, por edhe matematikën bazike dhe i pëlqen kur diskutojnë në klasë për mesazhet që përcjellin poezitë e ndryshme. Ligjëratat mbi prindërimin i pëlqejnë më së shumti sepse aty merr njohuri të reja mbi të drejtat e barabarta, mënyrën se si duhet t'i edukojë fëmijët e shumë tema të tjera, të cilat Lules sonë i kanë munguar gjithë këto vite. Si anë pozitive të martesës së saj ajo e sheh vetëm lindjen e fëmijëve.

Lulja është optimiste se në të ardhmen komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian do të vetëdijësohet më shumë sa i përket martesave të hershme dhe i porosit vajzat dhe gratë që të shkollohen dhe të avancohen sa më shumë.

Biseda me bashkëshortin e Lules

Për arsye të etikës së hulumtimit bashkëshortin e Lules e kemi quajtur "Bekim"

Bekimi ishte vetëm 16 vjeç kur u dashurua në Lulen, atëbotë 14 vjeçare. Nuk shkoi shumë kohë dhe ata u martuan me pajtimin e të dyja familjeve nëpërmjet të mësitnisë (ndërmjetësimit). Bekimi nuk është i shkolluar dhe merret me reciklimin e mbeturinave. Tani është 23 vjeçar, ka tre fëmijë dhe me vështirësi të mëdha e mban familjen sepse biznesi i reciklimit sjell pak të ardhura dhe kërkon shumë mund. Ai mendon se mosha e duhur për martesë është 20 vjeç.

"Ta kisha ditë që është kaq fshtirë me e majtë shpinë, isha martu ma vonë, jo qashtu i ri"! Bekimi tregon se në të kaluarën martesat janë lidhur edhe më herët, duke marrë si shembull prindërit e tij të cilët janë martuar në moshën 12 vjeçare. Ndërsa sot, ai thotë se ekzistojnë mundësi më të mira për t'u shkolluar dhe për t'u punësuar para se të martohesh, por prapë pohon se në Fushë Kosovë një numër i madh i vajzave janë duke u martuar në moshë shumë të re si 15 dhe 16 vjeç. Ai nuk ka kohë të dëgjojë shoqërinë dhe njerëzit e tjerë se çka mendojnë për martesat e hershme, por që eksperienca e tij i ka dhënë mësim dhe thotë që fëmijët e tij nuk do t'i lejojë që të martohen para moshës 20 apo 21 vjeç. I pyetur se çka mendon për Lulen dhe jetën e saj, ai me buzëqeshjë thotë; ***".....njejt edhe ajo edhe une qashtu kemi menu që ma mirë mu martu atëhere se jemi dashuru, po mandej e kemi pa se sa fshtir është, e sa probleme ka!"***

Si anë pozitive të martesave të hershme ai thotë se nusja e ndihmon nënën time në punët e shtëpisë, ndërsa nuk dëshiron të deklarohet për anët negative të martesave të hershme, përveç vështirësive të lartëpërmendura.

Biseda me nënën e Lules

Nëna e Lules është 41 vjeç dhe jeton në Fushë Kosovë.

Ajo rrëfen se si në moshën 16 vjeçare ka ikur nga shtëpia e saj dhe është martuar pa lejen e prindërve. Me ndrojtje tregon se ajo është dashuruar dhe për shkak të frikës se prindërit mund të mos ia pëlqenin të dashurin e saj, ka ikur nga shtëpia. Ajo tregon se në të kaluarën ka qenë koha shumë më ndryshe se sot; fëmijët nuk kanë folur me prindërit për dashuri, e lëre më për martesa e marrëdhënie intime. Nëna e Lules thotë se jeta e saj pas martesës ka ndryshuar shumë, por nuk është penduar që është martuar herët sepse ajo ka lindur fëmijë të shëndetshëm dhe ka krijuar familje. Sipas saj, mosha ideale për martesë është 18 vjeç. Ajo përveç Lules ka edhe 2 fëmijë të tjerë të cilët janë martuar në moshën 19 dhe 20 vjeç. Lidhur me jetën e vajzës së saj Lules, ajo thotë se Lulja është martuar në shtëpi të mirë dhe është martuar me mësitni (me ndërmjetësues). Përveç kushteve të vështira ekonomike, nëna e Lules nuk sheh ndonjë anë negative që vajza e saj është martuar herët. ***"Lulja e ka marrë qata që e ka dashtë.....ma mirë me u martue, se me ikë te burri!"***

Në lidhje me vajzat që vendosin të mos martohen herët, nëna e Lules nuk ka shumë komente. Ajo thotë se gjithkush i ka punët e veta; disa vajza dëshirojnë të rrinë më gjatë te familja e tyre, dëshirojnë të shkollohen dhe asaj nuk i interesojnë këto gjëra.

Biseda me shoqen e Lules

Shoqja më e mirë e Lules është 18 vjeç dhe jeton në Fushë Kosovë. Ajo ka kryer 7 vjet shkollë dhe më pas e ka ndërprerë mësimin për shkak se është dashur që të qëndrojë në shtëpi për t'i ndihmuar nënës së saj. Edhe pse e ka braktisur shkollimin, shoqja e Lules nuk planifikon të martohet së shpejti, por që dëshiron shumë që të punësohet dikund dhe të bëhet e zonja e vetes. Lidhur me martesat e hershme ajo thotë se ky fenomen është shumë i përhapur, por që nuk kujdeset askush që ta ndalojë këtë gjë. Shoqja e Lules pohon se martesat e hershme kanë qenë prezente edhe në të kaluarën, por edhe tash ka mjaft, madje ajo mendon se tash janë shpeshtuar, sepse të rinjtë nuk po i pyesin dhe nuk po i respektojnë më prindërit.

".....ma herët u kanë marre edhe qikat janë frigu me folë me prindërit për martesë, a tash është e kundërta, kërkush si vet prindërit hiq..... veq kur te nijmë që filonja shkoi te burri 15-16 vjeçe"!

E pyetur nësë ka pasur shoqe të cilat e kanë braktisur shkollimin për t'u martuar, shoqja e Lules thotë që jo, sepse ajo vetë e ka braktisur shkollimin në klasën e shtatë dhe nuk ka njohuri për këtë. Por në lidhje me shoqet e saj të cilat janë martuar herët, ajo thotë se disave u ka ndryshuar jeta për të mirë, e disave për të keq. Si shembull merr shoqet dhe fqinjet e saj të cilat kanë jetuar në kushte të mjerueshme në shtëpinë e tyre, ndërsa te burri kanë gjetur jetë më të mirë. Gjithashtu, i përmend edhe rastet e tjera, kur vajzat që janë martuar herët në shtëpinë e burrit bëjnë jetë të vështirë; ato më nuk janë të lira të dalin e të shoqërohen dhe shpesh kushtet ekonomike i kanë edhe më të vështira sesa në shtëpitë e tyre.

Lidhur me jetën e Lules ajo mendon se Lulja pavarësisht që është martuar herët, ka qenë zgjedhja e saj, por që më mirë është sikur të ishin shkolluar te dyja. Si anë pozitive të jetës së Lules, shoqja e saj konsideron se është mirë që Lulja ka fëmijë dhe është bërë nënë, ndërsa për anët negative thotë se nuk mund të komentojë për shoqen e saj më të mirë.

Biseda me mësuesen e Lules

Mësuesja e Lules me profesion është psikologe. Ajo punon në qendrën e mësimit dhe komunitetit të organizatës "The Ideas Partnership" si mësuese e klasave të shkrim-leximit për të rritur e gjithashtu mban edhe klasat e prindërimit. Ajo punon me 45 gra nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian e që vijnë rregullisht në qendër për të ndjekur aktivitetet.

Lidhur me martesat e hershme ajo thotë se kjo temë më nuk është tabu në shoqërinë tonë. Gratë me të cilat ajo punon shpesh rreféjnë copëza nga jeta e tyre dhe ndajnë eksperiencat me mësuesen duke treguar se si ka ndikuar martesa e hershme në jetën e tyre. Bazuar në përvojën e saj me gratë, ajo thotë se faktori kryesor shtytës i martesavë të hershme është gjendja ekonomike dhe socio-kulturore. Mungesa e arsimimit dhe komunikimit prind-fëmijë gjithashtu janë arsye të forta që e shpiejnë këtë dukuri në rritje.

Sa i përket dallimit të prezencës së kësaj dukurie nga e kaluara dhe tash, mësuesja e Lules u referohet rrëfimeve të grave me të cilat punon. Ajo thotë se kjo dukuri pëson ulje dhe ngritje por që gjithmonë është prezente. Dallimi kryesor sipas saj është se në të kaluarën nuk është marrë fare në konsideratë mendimi i vajzave, nëse ato vërtet dëshironin të martohen në atë moshë. Ndërsa në ditët e sotme, me zhvillimin e platformave vetëdijësuese për të drejtat e barabarta, të drejtat e grave dhe fëmijëve në përgjithësi mund të thuhet se situata ka ndryshuar.

Gjatë përvojës së saj ajo ka pasur majft raste kur vajzat e kanë braktisur shkollimin. Mësuesja pohon se zakonisht pas braktisjes së shkollimit pasoja e radhës është martesa e hershme. Iniciativa e organizatës sonë për të parandaluar fenomenet e tilla ka qenë insistimi ynë që ato vajza apo gra të reja ta vazhdojnë shkollimin në mënyra të ndryshme alternative. ***"Ne jemi munduar që të përkrahim këto raste me materiale shkollore, aktivitete të shkrim-leximit, prindërimit, mbështetje financiare si psh.bursë, dhe kemi insisituar në përforcimin e talenteve të tyre duke u ofruar programe atraktive përmes së cilave vajzat dhe gratë e reja e kanë kuptuar rëndësinë e shkollimit".***

E pyetur cila është lidhshmëria e shkollës me martesat e hershme dhe çka mund të bëjë shkolla për t'i ndaluar martesat e hershme, ajo pohon se është esenciale që shkollat ta kenë në planprogram edukimin seksual. Mungesa e informimit te të rinjtë i shtyn ata që t'i kërkojnë këto informata dikund tjetër apo që të eksperimentojnë vetë me jetën e tyre. Andaj, edukimi në familje dhe në shkollë janë dy faktorë kryesorë të cilët mund ta parandalojnë këtë fenomen.

Lidhur me jetën e nxënëses së saj Lules, mësuesja thotë se nuk mund t'i dallojë nxënëset pasi që për të janë të gjitha të barabarta dhe detyra e saj është që t'u japë këtyre grave dhe vajzave një rast të dytë për t'u edukuar. ***"Jo vetëm për Lulen, por për të gjitha gratë më të cilat punoj, ndjej keqardhje për rrjedhën e jetës së tyre, posaqërisht pas martesave në moshë të re. Ato tani janë vetë nëna, dhe tani e shohin rëndësinë e shkollimit e edukimit sepse shumica prej tyre ose nuk kanë qenë kurrë në shkollë, ose kanë kryer vetëm disa klasë. Shkollimi i tyre është ndërprerë pikërisht në moshën kur ato është dashur që të mësojnë, të informohen dhe të marrin vetëbesimin e duhur për tu pregaditur për jetë"!***

Si anë negative e martesave të hershme, mësuesja e Lules thekson: mungesën e shoqërimit, problemet shëndetësore e sidomos ato psiqike, stresi, depresioni dhe mungesa e gjindshmërisë në një situatë dhe rreth të ri. Shtimi i përgjegjësive si grua dhe nënë, mungesa e përkrahjes së prindërve dhe familjes, dhuna psikologjike e shpesh edhe fizike në shtëpinë e bashkëshortit janë poashtu faktorë pothuajse të pashmangshëm.

Andaj është shumë e rëndësishme që ne si shoqëri, me ndihmën e institucioneve përkatëse të organizohemi më mirë dhe të marrim më shumë iniciativa të cilat do ta parandalonin këtë dukuri.

10.1 Gjetjet kryesore të Studimit të Rastit

Martesat e hershme janë të lidhura ngushtë me traditën familjare, mungesa e shkollimit dhe komunikimit me prindër janë ndër shtytësit kryesorë. Papjekuria e të rinjve ndikon në lidhjen e martesave të hershme, ndërsa mospërgatitja për martesë dhe gjendja e vështirë ekonomike e vështirëson shumë jetën e të dy bashkëshortëve.

11. Konkluzionet

- Pjesa më e madhe e të intervistuarve nuk e kanë përfunduar arsimimin e obliguar me ligj.
- Shumica e familjeve të respodentëve të intervistuar burim të vetëm të të ardhurave e kanë asistencën sociale dhe asnjë prej tyre nuk është i punësuar me kontratë pune.
- Martesat tek komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në të shumtën e rasteve realizohen në mënyrë tradicionale pa procedura ligjore.
- Gjatë intervistimit ka pasur raste kur respodentët kanë deklaruar se kanë lidhur martesë tradicionale në moshën 13 vjeçare.
- Presioni nga ana e prindërve për të marrë vendim për martesë është evident tek të dy gjinitë, por një numër i vogël i respodentëve kanë deklaruar se ka qenë vendim i tyre personal që të martohen.
- Ekspozimi i vazhdueshëm ndaj një lloji të caktuar jetese që e simulon martesën e hershme dhe krijimin e familjes në moshë të re ka krijuar një tërësi vlerash që pjesëtarët e rinj të komuniteteve i marrin si të mirëqena dhe i përvetësojnë si norma në mënyrë të padijshme.
- Në bazë të gjetjeve në terren, shkak i martesave të hershme del të jetë mentaliteti i komuniteteve, ku vlen të theksohet se shumica e të intervistuarve konsiderojnë se mosha gjashtëmbëdhjetë deri tetëmbëdhjetë vjeç, është periudha e duhur për martesë.
- Një pjesë e konsiderueshme e respodentëve kanë njohuri se ekziston ndalesa ligjore për martesat nën tetëmbëdhjetë vjeç pa lejen e gjykatës.
- Organizata "The Ideas Partnership" përmes aktiviteteve ka arritur të përfshijë pjesën më të madhe të komuniteteve, gjë që kuptohet edhe nga përgjigjet e respodentëve ku pjesa më e madhe e tyre kanë deklaruar se kanë qenë pjesë e programeve të kësaj organizate.

12. Rekomandimet

- Organizim i fushatave vetëdijësuse për pasojat e martesave të hershme.
- Marrja e masave për parandalimin e martesave që nuk përfshihen në kornizat ligjore dhe të akteve juridike që e rregullojnë këtë status civil të personave nën moshën 18 vjeçare.
- Krijimi i programeve për aftësim profesional për pjesëtaret e komuniteteve, në veçanti për vajzat dhe gratë.
- Programet qeveritare të cilat përfshijnë metoda të ndryshme stimuluese për të rinjtë të cilët vijojnë edukimin dhe nuk lidhin martesë tradicionale në moshë të hershme.

**Ky studim është publikuar me mbështetjen e Dannish Refugee Council - Kosovë. Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura këtu, në asnjë mënyrë nuk mund të pasqyrojnë mendimin zyrtar të Dannish Refugee Council - Kosovë.*